



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 11, datë 04.12.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:13

Data e mbajtjes së mbledhjes : 04.12.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi : Përsëndetje! Fillojmë.

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës. Në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetari i bashkisë dhe zëvendëskryetari i këshillit. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit. Ftoj sekretaren të bëjë prezencën.

Dorina Milja : Përsëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

36 këshilltarë në sallë.

(V.O. Hyn me vonesë në sallë këshilltarja Marsida Feshti). Gjithsej 37 këshilltarë gjatë mbledhjes.

Denisa Luarasi : Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kalojmë me leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN NËNTOR 2025
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË ALOKUAR NGA BUXHETI I SHTETIT NË ZBATIM TË VKM NR. 483, DATË 02.09.2025, “PËR DHËNIE SHPËRBLIMI PERSONELIT TË ANGAZHUAR NË OPERACIONET PËR SHUARJEN E ZJARREVE GJATË VITIT 2025”
Pika 3 dhe e fundit	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË Durrës PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2026

Keni ndonjë koment..?

Jeni dakort me rendin e ditës?

Kalojmë votim, kush është pro rendit të ditës?

Dorina Milja : 37 pro, se ka ardh dhe Marsida.

Denisa Luarasi : Me 37 vota pro kalojmë. Miratohet rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit.

Dorina Milja : Xhiliola, pasi nuk është as Flori, as Edlira.

Denisa Luarasi : Zonja Xhiliola Doçi.

Xhiliola Doçi : Komisioni jonë u mbledh dhe me shumicë votash miratoi kalimin e pikës 1, për votim në Këshillin Bashkiak.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit zonja Doçi.

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 1 të rendit ditës?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Komisioni ynë e diskutoi pikën 2 dhe e miratoi me shumicën e votave të anëtarëve. Ftojme këshillin sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

I jepet fjala Komisionit të Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave zotit Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Përshëndetje të gjithëve.

Edhe komisioni jonë u mblodh e miratoi pikën për kalim në Këshillin Bashkiak për miratim, duke theksuar që është një mbështetje shumë e mirë për një sektor shumë të rëndësishëm dhe besoj që do të shërbejë për një vëmendje të posaçme për Sektorin e Zjarrfiksave dhe nga Bashkia jo vetëm nga Qeveria.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente kemi për pikën 2 të rendit ditës?

Po zoti Muka.

Ardian Muka : Mirëdita të gjithëve.

Natyrisht jam dakort për dhënien e shpërblimit të personelit të angazhuar në operacionet dhe shuarjen e zjarrit gjatë vitit 2025, por edhe gjithë punën e tyre që ato kanë bërë edhe vite të shkuara. Duke pasur parasysh që qyteti jonë është një qytet i shtrirë, ka zona kodrinore ku ka sipërfaqe të tëra ku zhvillohen mundësitë për zjarre. Do thoja që ne mos mjaftohemi thjesht në dhënien e këtyre kontributeve, që për mendimin tim janë minimale për këto njerëz që në fund të ditës kur bjen zarri neve i shpallim heronj, por atyre duhet t'i japim mundësinë dhe infrastrukturën e domosdoshme që ato të përballen ashtu siç duhet me këtë problem që mos e dhënë zoti të përballemi. Por neve duhet të marrim masat.

Pra, do propozoja që në projekt-buxhetin që do na sillni, të shihet mundësia për çfarë këto njerëz kanë nevojë. Qoftë në nivel infrastrukture, qoftë në nivel organizimi, të na vijë si propozim ta gjykojmë dhe pse jo, thashë kur flitet për një të mirë të përbashkët dhe për marrjen e masave që mos ndodhin incidentet, neve do jemi përherë pozitiv në këto zhvillime. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Komente të tjera keni?

Kalojmë në votim...?

Kush është pro për pikën 2 të rendit të ditës?

Me 37 vota pro, miratohet pa ndryshim dhe pika 2 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 3**, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, komisioni ynë edhe për pikën 3, shprehet dakort edhe ftojme Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

Komente keni për pikën 3?

Po Muka.

Ardian Muka : Nuk ndizet. U ndez mikrofonin..

Më shumë një konstatim, natyrisht duke pasur parasysh problematikat që qyteti jonë ka në lidhje me procesin e rindërtimit. Këtu është parashikuar që do trajtohet kjo çështje, por duke pasur parasysh që hyjmë në vitin e gjashtë, viti shtatë 2026-ta. Do të doja që të ishim më të përqëndruar dhe më konkret. Pra, të paktën nga ana e legjislacionit, neve duhet t'i paraprijmë këtij procesi dhe brenda vitit tjetër si legjislacion neve duhet ta përmbyllim. Si proces ai mund të vazhdojë, sepse natyrisht varen nga mundësitë financiare, varen nga shumë faktorë të tjerë, por nga ana legjislative nuk mund ta tërheqim më zvarrë prej gjashtë vitesh të hyjmë në vitin e shtatë. Këtë kisha sugjerim Ta marrim parasysh që në punimet që neve do kemi, brenda vitit tjetër ky Këshill me propozimet që do na sjellë edhe bashkia, neve ta përmbyllim si proces. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Ndonjë koment tjetër?

Po.

Munir Konesha : Tani unë përfitoj nga rasti, meqenëse kemi miratimin e programit të punës së Këshillit, unë kam një sugjerim që vendimet e Këshillit që kanë të bëjnë me buxhetin e Bashkisë të trajtohen me më shumë sesa komisioni aktual që është Komisioni i Buxhetit dhe i Taksave, të jetë më transparent dhe ato debate, ato problematikat që mund të dalin të trajtohen në shumë komisione. Jo, jo si sot.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit.

Munir Konesha : Një minutë. Po historikisht ne e kemi trajtuar buxhetin vetëm me Komisionin e Financës, Buxhetit dhe Taksave deri më sot aktualisht. Unë sugjeroj që të jetë më i gjërë në konferencat e kryetarëve, diskutoni që mund ta shpërndani edhe këtë në shumë komisione.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit.

Do e kemi parasysh.

Po..? Zonja Musaraj.

Joniada Musaraj : Mos t'i lëmë shkas dhe kundërshtarëve tanë politikë. Sqaroj dhe kolegun që pika 3 nuk lidhet me buxhetin, ka të bëjë me programin e punës së Këshillit, që ne të gjithë bashkarisht dhe Kryetarët e Komisioneve e kemi diskutuar dhe na është dhënë mundësia që të japim propozime. Propozimet që ne kemi për ndryshime apo rregullime në vijim. Kështu që dhe në lidhje me buxhetin sa herë është ka qenë e nevojshme të gjitha pikat kalojnë sipas përkatësisë së komisioneve kështu që, besoj se procedura është respektuar gjithmonë dhe jam e bindur për këtë. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

Po Konesha... s'ka problem.

Munir Konesha : Nuk dua të bëj replikë se s'ishte vend për replikë. Unë kërkoj. A e ke parasysh se në programin pra që ishte në dhjetor, do kaloj vetëm te Komisioni i Taksave të dhjetorit 2026, vetëm Komisioni i Taksave dhe të Buxhetit. Unë shpreh një propozim që të jetë më shumë sesa një komision. Nuk thashë se është në kundërshtim me procedurën. Kjo ishte.

Denisa Luarasi : Mund të marrësh pjesë, je i ftuar në çdo komision?

Mund të marrësh pjesë pa të drejtë vote mund të vish edhe të marrësh pjesë dhe të japësh patjetër sugjerimet e tua.

Munir Konesha : Dakort, mbajeni kështu siç e keni.

Denisa Luarasi : Megjithatë, ne do e mbajmë shënim. Do ta kemi parasysh.

Shumë faleminderit zoti Konesha.

Tjetër koment..? Jo...?

Kalojmë votim..?

Kush është pro për pikën 3 të rendit të ditës?

Me 37 vota pro, miratohet pa ndryshime dhe pika 3 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** nënkryetarja e këshillit zonja Edlira Devolli.

Edlira Devolli : Faleminderit Denisa. Përhëndetje të gjithëve.

Unë do flas pak për pallatin numër 971, rruga “Petrela”. Pra, në lagjen 18. Është një pallat me 5(pesë) kate dhe konkretisht kati i 5-të është tepër i dëmtuar, dhe nga lagështia, dhe nga pesha e depozitave. Soleta ka bërë një hark dhe rrezikon që të shëmbet. Çfarë mund të bëjë Bashkia për këtë? Është pyetja ime. Dhe ndërhyrja duhet menjëherë pasi ka rrezik shembjeje.

Në fasadë është ndërhyrë nga Bashkia, ndërsa brenda është gati katastrofike. Kam një pamje nga një nga banesat e katit të pestë, që është tepër, tepër e dëmtuar. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Devolli.

Po nënkryetar.

Elio Jani : Po. Faleminderit zonja Devolli për pyetjen.

Faktikisht ajo është një problematikë që ne e kemi hasur prej pak ditësh. Kemi kontaktuar dhe me banoren. Ai është një investim që është kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në lagjen 18 dhe 16. Ne si Bashki kemi ngritur një grup pune për evidentimin e të gjithë problematikave që janë, sepse kemi hasur disa problematika. Përveç këtij rasti kemi disa raste të tjera dhe për fat të mirë punimet nuk kanë mbaruar, është në periudhën e garancisë së punimeve dhe në bashkëpunim me firmën të gjithë problematikat që do hasin për çdo qytetar, ne do marrim masat t’i rregullojmë ato sipas kontratës, që kemi lidhur me operatorin. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit nënkryetar.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Takohemi në mbledhjen e radhës.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 6 (gjashtë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesi i seancës, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Nikol Muka

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak : DORINA MILJA

Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : EDLIRA DEVOLLI

Këshilltar (Kr. Grupi) : LUAN NEZHA

Këshilltar (Kr. Grupi) : DRITAN BURGIJA